



Fillimi > -Kronikë

VIDEO/ Armë, municion dhe kanabis, arrestohet 40- vjeçari në Memaliaj

15 Janar, 2020 13:12 | 0 shfletime



Madhësia e tekstit: ○ ○



Një 40- vjeçar është arrestuar në Memaliaj pasi është kapur me armë dhe drogë. D.K, i janë gjetur gjatë operacionit policor ‘Vjosa’, një armë zjarri tip pushkë, dy armë gjahu pa leje dhe municion luftarak në banesën e tij. Po ashtu u gjet një sasi kanabisi prej 1.5 kg në automjetin e tij.

Informacionet Policia për 40- vjeçarin i kishte marrë në rrugë operative nga qytetarët.

Operacioni 'Vjosa', arrestohet 40- vjeçari në Memaliaj



NJOFTIMI I POLICISË



Finalizohet me sukses operacioni policor i koduar “Vjosa”.

Sekuestrohen armë zjarri, drogë e municion luftarak.

Arrestohet në flagrancë poseduesi.

Në vijim të kontrollit të territorit për parandalimin, evidentimin dhe goditjen e paligjshmërisë, bazuar dhe në informacionet e siguruara në rrugë operative nga qytetarët, shërbimet e Komisarariatit të Policisë Tepelenë dhe shërbimet e Stacionit të Policisë Memaliaj, në bashkëpunim me specialistët e Seksionit të Hetimit të Trafikeve dhe Narkotikëve në DVP Gjirokastër organizuan dhe finalizuan operacionin “Vjosa”.

Si rezultat i këtij operacioni u arrestua në flagrancë shtetasi D. K., 40 vjeç, banues në fshatin Buz, Memaliaj, pasi shërbimet e Policisë, gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e këtij shtetasi gjetën një armë zjarri tip pushkë, dy armë gjahu pa leje dhe një sasi municioni luftarak. Gjithashtu, në automjetin e këtij shtetasi u gjet një sasi lënde narkotike cannabis sativa rreth 1.5 kg, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, për hetime të mëtejshme, për veprat penale “Mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, “Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike” dhe “Mbajtja pa leje e